

U D H Ë Z I M
Nr. 5, datë 18.6.2002

**PËR PRODHIMIN, SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E FLETËVOTIMEVE NGA
KQV-TË E ZONËS ZGJEDHORE NR.19 PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR DEPUTETË
TË DREJTPËRDREJTË PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 7.7.2002**

Në mbështetje të nenit 89 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. Për zgjedhjet e pjesshme të datës 7.7.2002 për deputetë të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore nr.19 për Kuvendin e Shqipërisë, fletëvotimeve për këtë zonë të prodhohen në masën 2% mbi numrin e përgjithshëm të votuesve në listat përfundimtare të zgjedhësve.

2. Shpërndarja e fletëvotimeve nga KZZ-ja nr.19 në çdo KQV të bëhet si vijon:

a) Pjestohet numri i fletëvotimeve që i janë dhënë KZZ-së nr.19 nga KQZ-ja, me numrin e votuesve të listës përfundimtare të zgjedhësve të kësaj zone dhe rezultati i pjestimit shumëzohet me numrin e votuesve të listës përfundimtare të qendrës nr.1 të votimit. Rezultati që del nga shumëzimi është numri i fletëvotimit që KZZ-ja nr.19 duhet t’i japë KQV-së përkatëse. Me të njëjtën procedurë përcaktohet edhe numri i fletëvotimeve për qendrat e tjera të votimit të zonës zgjedhore nr.19.

b) KZZ-ja nr.19 nuk mban asnjë fletëvotimi gjendje (rezervë).

3. Për përdorimin e fletëvotimeve komisionet e qendrave të votimit veprojnë si vijon:

Në fillim të çeljes së votimeve kryetari dhe zëvendëskryetari firmosin deri 50 copë fletëvotimi, të cilat vulosen nga sekretari i KQV-së një nga një në momentin që i jepen votuesit. Më tej, firmosja e fletëvotimeve do të shkojë paralel me intensitetin e paraqitjes së votuesve dhe në total në fund të procesit të votimit duhet të jenë firmosur, vulosur dhe përdorur aq fletëvotimi sa votues kanë marrë pjesë në votim.

Fletëvotimet e papërdorura nuk duhet të kenë firma e vulë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.